

AKT THEMELIMI
“L.E.Technik”
Shpk

*Sot me datë **07.08.2023** në mbështetje të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” themeluesit e shoqërisë hartojnë Aktin e Themelimit si më poshtë vijon;*

THEMELUES:

Laert Haxhillari, atësia Fisnik, mëmësia Merita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga: Asim Vokshi, Nd.86, H.1, Njësia Administrative nr. 11, Tiranë (adresa e plote), lindur më 06.06.1983, gjendja civile “i martuar”, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 035504452 dhe nr. personal I30606065D,

Elton Haxhillari, atësia Fisnik, mëmësia Merita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë me adresë: Rruga: Sami Frashëri, Pall, 48, Shk 1, Ap 16, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë, lindur më 08.09.1978, gjendja civile “i martuar”, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 035203575 dhe nr. personal H80908041D,

NENI 1
STATUSI JURIDIK

Shoqëria Tregtare “**L.E.Technik**” SHPK është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, (në vazhdim referuar si “Shoqëria”). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.
Ajo ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

NENI 2
EMRI I SHOQËRISË, VULA

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**L.E.Technik**” SHPK.
Shoqëria ka vulën dhe logon e saj identifikuese, të cilat do të figurojnë në çdo dokument zyrtar të lëshuar prej saj.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:
Mirëmbajtja dhe riparimi i artikujve e pajisjeve metalike, plastike (PVC), prej xhami etj.

NENI 4
SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Tiranës, në adresën: Rruga: Sami Frashëri, Pallati nr. 17, Tiranë

NENI 5
KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota me vlerë nominale të një kuote prej 50 (pesëdhjetë) lekë.

Laert Haxhillari zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 50 % të tij në vlerën 50 (pesëdhjetë) lekë.

Elton Haxhillari zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 50 % të tij në vlerën 50 (pesëdhjetë) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total.

NENI 6
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin e Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 7
ORGANET DREJTUESE

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund të zgjidhen për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë “L.E.Tekchnik” SHPK., është **Z. Laert Haxhillari** atësia Fisnik, mëmësia Merita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga: Asim Vokshi, Nd.86, H.1 Njësia Administrative nr. 11, Tiranë (adresa e plotë), lindur më 06.06.1983, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 035504452 dhe nr. personal I30606065D, i cili zgjidhet për një periudhë **5 vjeçare** me të drejtë ripërtëritje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8
LIGJI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortakët Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

THEMELUES:

Laert Haxhillari _____

Elton Haxhillari _____ 